



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHE ARREZ
Sektori i Menaxhimit te Burimeve Njerëzore

Nr. 365 Prot.

Fushë-Arrëz, me 06.02.2025

**SHPALLJE PËR LËVIZJEN PARALELE DHE PËR PRANIMIN NE
SHERBIMIN CIVIL**

Lloji i diplomës “Shkenca Juridike ” niveli minimal i diplomës “Master Shkencor”

Në zbatim të nenit 26, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, si dhe të Vendimit nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, Sektori i Burimeve Njerëzore pranë Bashkisë Fushë-Arrëz shpall procedurat e lëvizjes paralele dhe të pranimit ne sherbimin civil për pozicionin si më poshtë:

1(nje) Specialist i Sektorit të Burimeve Njerëzore, kategoria IV-3

Pozicioni më sipër, i ofrohet fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele! Vetëm në rast se në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ky pozicion është ende vakant , ai është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së konkurimit nga jashtë.

Për të dy procedurat (*lëvizje paralele dhe pranim ne sherbimin civil*) aplikohet në të njëjtën kohë !

Afati për dorëzimin e dokumentave për LËVIZJE PARALELE	20.02.2025
Afati për dorëzimin e dokumentave për NË SHËRBIMIN CIVIL	25.02.2025

Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionet si më sipër është:

- Administron, plotëson dhe përditëson dosjet e punonjësve, librezat e punës dhe regjistrin e personelit;
- Asiston njësitë organizative të institucionit në lidhje me proceset e lidhura me vlerësimin e rezultateve në punë dhe hartimin e përshkrimeve të punës;
- Administron lëvizjen e vlerave materiale të magazinës;

- Të prezantojë tek Përgjegjësi i Sektorit dokumentat dhe materialet e prodhuara nën përgjegjësinë e tij.
- Harton planin e trajnimeve të stafit dhe statistikat për trajnimet e kryera;
- Përgatit dokumentacionin dhe ndjek proceset për rekrutimin, emërimin, transferimin, zëvendësimin, largimin, masat disiplinore të punonjësve;
- Kryen detyra të tjera të dhëna nga Drejtori i Drejtorisë, në varësi të dinamikës së punës.

1 LËVIZJA PARALELE

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha insitucionet pjesë e shërbimit civil.

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:

- Të jenë nëpunës civil i konfirmuar, brenda së njëjtës kategori (IV-3)
- Të mos kenë masë disiplinore në fuqi
- Të kenë të paktën vlerësimin e fundit “mirë” apo “shumë mirë”

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:

- Të zotërojnë diplomë të nivelit “Master” (minimalisht) në Shkenca juridike , Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit duhet të jenë të njesuara pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave.
- Të kenë të paktën 2 vit përvojë pune.
- Të kenë njohuri të mira të paketës Aftësi të shkëlqyera në përgatitjen dhe analizimin e dokumenteve ligjore.
- Të kete aftësi të mira organizative dhe menaxheriale.

1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë pranë Sektorit të Burimeve Njerëzore të Bashkisë Fushë-Arrëz dokumentat si më poshtë:

- Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:
<http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/60-jeteshkrimi-standard>
- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën Bachelor). Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit;
- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në Sektorin e Burimeve Njerëzore të Bashkisë, brenda datës 20.02.2025

1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën 20.02.2025, Sektori i Burimeve Njerëzore do të shpallë në faqen zyrtare të Bashkisë Fushë- Arrëz, faqen zyrtare të internetit dhe në portalin "Shërbimi Kombëtar i Punësimit", listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta duhet të paraqiten në Zyrën e Burimeve Njerëzore pasi do të njoftohen individualisht për shkaqet e moskualifikimit (nëpërmjet adresës së e-mail).

1.4

FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- Ligji 7961 datë 12.07.1995 "Kodi i punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar;
- Ligji nr 9131 datë 08.09.2003 "Për rregullat e etikës në administratën publike", i ndryshuar;
- Ligji nr 44/2015 "Kodi i procedurave administrative";
- Njohuri në lidhje me ligjin 152/2013 "Për ëpunësin civil" i ndryshuar;
- VKM nr. 833, datë 28.10.2020 "Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit";
- Ligji nr 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore"

1.5

MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar:

Kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe çertifikimin pozitiv ose për vlerësimet e rezultateve individuale në punë në rastet kur procesi i çertifikimit nuk është kryer. Totali i pikëve për këtë vlerësim është 20 pikë.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
 - Eksperiencën e tyre të mëparshme;
 - Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.
- Totali i pikëve për këtë vlerësim është 40 pikë.

1.6

DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Sektori i Burimeve Njerëzore do të njoftojë fituesin në Këndin e Njoftimeve të Bashkisë Fushe-Arrez dhe në portalin Shërbimi Kombëtar I Punësimit. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht nëpërmjet adresës së email-it të vendosur në jetërshkrim.

2

PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL

Vetëm në rast se pozicioni i renditur në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil. Këtë informacion do ta merrni në faqen zyrtare të Bashkisë Fushe-Arrez dhe në portalin Shërbimi Kombëtar I Punësimit, duke filluar nga data 20.02.2025

2.1 KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E PRANIMIT NË SHËRBIMIN CIVIL DHE KRITERET E VEÇANTA

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë kandidatët jashtë sistemit të shërbimit civil, që plotësojnë kërkesat e përgjithshme sipas nenit 21, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar.

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e pranimit në shërbimin civil janë:

- a - Të jetë shtetas shqiptar;
- b - Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c - Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- d - Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- e - Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
- f - Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar.

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:

- a - Të zotërojnë diplomë të nivelit “Master” (Minimalisht) në Shkenca Juridike , Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit duhet të jenë të njesuara pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave.
- b- Të kenë të paktën 2 vit përvojë pune.

c - Të kenë njohuri të të mira të paketës Aftësi të shkëlqyera në përgatitjen dhe analizimin e dokumenteve ligjore.

d - Të ketë aftësi të mira organizative dhe menaxheriale.

2.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

a - Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:

<http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/60-jeteshkrimi-standard>

b - Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën Bachelor). Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit;

c - Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);

d - Fotokopje të letërnjoftimit (ID);

e - Vërtetim të gjendjes shëndetësore;

f - Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;

g - Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;

h - Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;

i - Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

Aplikimi dhe dorëzimi i të gjitha dokumenteve të cituara më sipër, do të bëhen pranë Sektorit të Burimeve Njerëzore të Bashkisë Fushe-Arrez Brenda datës **25.02.2025**

2.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **28.02.2025** Sektori I Burimeve Njerëzore do të shpallë në Këndin e Njoftimeve dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, listën e kandidatëve që plotësojnë kriteret e veçanta për procedurën e pranimit nga jashtë, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kriteret e veçanta për procedurën e pranimit nga jashtë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike për shkaqet e moskualifikimit (nëpërmjet adresës së e-mail).

2.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI DHE INTERVISTA

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- Ligji nr 9131 datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”, i ndryshuar;
- Njohuri në lidhje me ligjin 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar;
- Ligji nr 44/2015 “Kodi i procedurave administrative”;

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

2.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- Vlerësimin me shkrim, deri në 40 pikë;
- Intervistën e strukturuar me gojë që konsiston në motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në 40 pikë;
- Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 20 pikë.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike “[ëëë.dap.gov.al](http://www.dap.gov.al)”

<http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/54-udhezim-nr-2-date-27-03-2015>

2.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Sektori i Burimeve Njerëzore do të shpallë fituesin në faqen zyrtare të Bashkisë Fushe-Arrez dhe në portalin Shërbimi Kombëtar i Punësimit. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht nëpërmjet adresës së email-it të vendosur në jetëshkrim.

Përgjegjese e Sektorit të Burimeve Njerëzore
Fationa Selimaj



KRYETARI
Hil CURRI

